

E HËNË DATA 13 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETES DHURATA ÇUPI

Të nderuar kolegë,

Sot, në datën 13.02.2023, u mbledh Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për verifikimin e mandatit të deputetit, zotit Gëzim Nuri Ademaj, i ardhur nga lista shumëmemërore e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, qarku i Vlorës. Po paraqesim në mënyrë të përmbledhur këtë raport të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për verifikimin e mandatit të deputetit, zotit Gëzim Nuri Ademaj. Kuvendi, në mbështetje të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, i është drejtuar KQZ-së për ta njoftuar për vakancën e krijuar pas dorëheqjes së zotit Fatjon Veizaj nga mandati i deputetit. Për shkak të njoftimit të vakancës, KQZ-ja, me vendimin nr. 46, datë 10.02.2023, i ka dhënë mandatin e deputetit kandidatit vijues të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, zotit Gëzim Nuri Ademaj. Pas verifikimit që iu bë mandatit të fituar dhe krahasimit me legjislacionin e aplikueshëm, rezulton se në vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë respektuar kërkesat e parashikuara në nenet 69, 70 dhe 71 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sa i takon procedurës së dhënies së mandatit, është respektuar neni 164, pika 2, i ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, sipas të cilit mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, si dhe është ruajtur balanca e gjinisë së përfaqësuar.

Në konkluzion, sa më sipër, Këshilli vlerësoi se për deputetin, zotin Gëzim Ademaj, nuk rezulton asnjë paligjshmëri në zgjedhje që ta pengojë atë të bëjë betimin sot në seancën plenare. Për pasojë, zoti Gëzim Ademaj, i cili ka fituar mandatin e deputetit, në mbështetje të nenit 4, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, ftohet në seancën plenare të Kuvendit për të bërë betimin, si kusht për të filluar ushtrimin e mandatit të deputetit. Suksese, zoti Ademaj! Faleminderit!